



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 30.11.2018, me fillim në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-225

PROCESVERBALI

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Duda Balje, Slobodan Petrovic dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavjević dhe Zoran Mojsilović,

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic , OSBE; Pleurat Kurti EUSR; Hajrudin Skënderi, Ambasada Suedeze; Ndriçim Çekaj, KDI; Zijush Ahmeti, KKK; dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit me datë 27.07.2018 dhe 10.10.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me raport amendamente të Komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me raport amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetar- Xhelal Sveçla, propozoi që rendi i ditës të plotësohet me tri pika të reja,: Shqyrtimi Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Zëvendëskryetari konstatoi, se Komisioni unanimisht miratoi rendin e ditës me plotësimin e tri pikave të reja, të renditura si pika 9,10 dhe 11, me tekstin si në vijim: Shqyrtimi Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit me datë 27.07.2018 dhe 10.10.2018;

Zëvendëskryetari konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 27.07.2018 dhe 10.10.2018, u miratuan njëzëri, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me raport amendamente të Komisionit funksional për Punët të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

- 7. Shqyrtimi i Projektligji nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me raport amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, me raport amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me raport amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Veton Berisha, në bazë të shqyrtimit të Projektligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ai propozoi të shtohen 2 amendamente, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 5 të Projektligjit, në paragrafin 1, pas fjalëve. ‘ nga shtetasit e Republikës së Kosovës’ të shtohet fjala ‘ duke siguruar përfaqësim të të gjitha komuniteteve jo-shumicë në minimum 10% të numrit të përgjithshëm.

Amendamenti 2

Në nenin 17 të Ligjit, paragrafi 2.6 i projektligjit, të fshihet.

Dha shpjegim për amendamentin.

Neni 17 mbi kompetencat dhe përgjegjësit e Kryeministrit, paragrafi 2.6 përcakton se Kryeministri ka kompetence ‘ të përcaktojë minimumin e përfaqësimit të të gjitha komuniteteve brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ‘. Minimumi i përfaqësimit të komuniteteve duhet të përcaktohet me këtë ligj, përkatësisht sipas propozimit në amendamentin e parë dhe jo të mbetet kompetencë diskrecionale e Kryeministrit.

Sipas qëndrimit të tij, e përkrah në parim Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Sa i përket të drejtave të komunitetit joshumicë, duhet të respektohet kuota prej 10% në forcën e sigurisë. Kjo çështje nuk duhet të mbetet në vullnetin e Kryeministër apo ndonjë personaliteti tjetër, por të rregullohet me ligj. Gjithashtu, nuk mund ti referohemi regjistrimit të fundit të popullsisë, sepse ne e konsiderojmë jo të plotfuqishëm, nga fakti se gjatë regjistrimit kanë marrë pjesë vetëm dy regjistruar të komuniteteve. Dhe, ka pas organizime të ndryshme me qëllim që të mos përmbushet kuota prej 10% për komunitetet joshumicë, në Komuna.

Kërkesa e tij ishte që të marr përkrahjen nga anëtarët e komuniteteve të cilët janë prezent dhe të miratohet propozim amendamentet, me qëllim që komuniteti joshumicë të ketë përfaqësim të denjë.

Duda Balje, kemi pasur çdo herë, bashkëpunim shumë të mirë me ministrin e FSK-së.

Kamë kërkuar nga ministria e FSK-së të dërgojnë listën, e cila ka të bëjë me numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë brenda kësaj ministrie. E thotë me keqardhje, se deri më sot nuk është marr asnjë informacion lidhur me këtë kërkesë.

Theksoi se është pajtohet të miratohen të tre P/ligjet, me arsye që të formohet Ushtria e Kosovës.

Në bazë të vendeve të rezervuara, janë të punësuar pjesëtarë nga rrada e komuniteteve tjera dhe kjo situatë sjellë pakënaqësi për komunitetin joshumicë.

Dihet se përfaqësimi i komunitetit serb është në numër më të madh, andaj kërkoi që të respektohet kuota prej 10 % në emër të komunitetit joshumicë. Propozimi i saj konkret ishte që përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në FSK, të rregullohet me Ligj.

Ndërkohë, lexoi Nenin 17 të projektligjit, ku thuhet se Kryeministri ka kompetence të përcaktojë minimumin e përfaqësimit të të gjitha komuniteteve brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë. Me këtë përmbajtje, përfaqësimi i komuniteteve joshumicë janë përfshirë në Ligj. Në fund, deklarohet se përkrah raportin e komisionit funksional dhe se do të votojë projektligjin në Seancë Plenare.

Danush Ademi, përkrah propozimin e kolegut lidhur me amendamentet e të dhëna.

Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e komuniteteve, duhet të respektohet kuota prej 10 %, të përcaktuar me Ligj . Mirëpo nëse e bëhet krahasimi i përfaqësimit të komuniteteve, ne jemi të përfaqësuar vetëm 2%, ndërsa komuniteti serb 8% . Kërkojë që Qeveria të jetë më korrekte në rastin e përfaqësimit të komunitetit që unë përfaqësojë.

Unë jam i informuar lidhur me numrin e anëtarëve të komuniteteve që veprojnë në FSK-në, dhe nëse për nga përqindja bëhet krahasimi, shihet se 70% janë të inkuadruar nga komuniteti serb ndërsa 30 % nga radha e komunitetit joshumicë. Në bëhet krahasimi i kësaj pasqyre, del se nuk i takon asnjë përqindje komunitetit romë, i cili është në numër më të madh nga radha e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Mund të them se janë të kuqur vetëm 20 pjesëtar të komunitetit rome në FSK-në, dhe kjo situatë në vazhdimësi po dëmton këtë komunitet.

Ishte i mendimit që në baza ligjore duhet të rregullohet çështja e përqindjes e cila proporcionalisht i takon të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Muferra Sërbica Shinik, në interes të komuniteteve është ngritja e çështjes së përfaqësimit në baza etnike, në të gjitha institucionet. Nëse me këtë projektligj nuk do të ketë përfaqësim të drejtë, atëher do të paraqiten problemet e njëjta si në rastin e shpalljes së konkursit për policë.

Konsideron se përcaktimi i numrit të komuniteteve joshumicë brenda Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk duhet të mbetet në vullnetin e Kryeministri, nga se ai nuk është Ligj e as Kushtetutë.

Kërkoi nga anëtarët e komunitetit joshumicë të përfaqësuar në këtë komision, të votojnë amendamentet e propozuara nga kolegu Veton Berisha.

Kujtim Shala, nuk do të flasë për propozim amendamentet por do të përqendrohem në mënyrën e procedimit të Projektligjeve në Kuvend. Në këtë mandat, fushëveprimi i komisionit është ti shqyrtojë raportet e komisioneve Funktionale, ligjet dhe materialet tjera, me qëllim të adresimit në aspektin e mbrojtjes të të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Proceduralisht, si komision nuk kemi të drejtë të dalim me amendamente të reja. E them këtë nga se ky komisioni nuk ka të drejtë të miratojë kërkesa të kësaj natyre. Të drejtë për të propozuar amendamente kanë deputetët individualisht dhe të njëjtat duhet të dërgohen për shqyrtim në komisionin Funkcional. Propozim i tij konkret ishte që kjo çështje mund të ngitet si vërejtje në Seancë Plenare.

Haxhi Shala, theksoi se në Projektligjin për Forcat e Sigurisë, përfshihet edhe çështja multietnike e cila do të përfaqësohet sipas regjistrimit të fundit nga radha e komuniteteve. Si shembull murr rastin, nëse i përket përqindja prej 3% nga radha e komunitetit boshnjak, ashtu do të qëndrojë.

Në momentin e shpalljes së konkursit në FSK, kandidatët bazohen në bazë të vendeve të merituar, dhe përfaqësimi i takon në bazë të regjistrimit të fundit, pra nuk ka hapësirë për vende të rezervuara.

Sa i përket çështjes së ngritur, theksoi se GP 6+ e ka përfaqësuesin e tyre në komisionin funksional, i cili është dashtë t' ju informojë, se është arrit akordim për propozimet e miratuara në komision.

Sido qoftë, nëse ky komision do të paraqet amendamente të reja, ne do ti shqyrtojmë si komisionin funksional dhe më pas do të dalim me përfundim të cilin e merr komisioni jonë.

Veton Berisha, deklarohe se nuk ka njohuri, për cilat amendamente është akorduar në komisionin funksional. Mendon se kishte qen e drejtë që të informohemi me kohë nga anëtarë i GP 6+ . Konsideron se duhet të respektohet kuota prej 10%, njëjtë për të gjitha komunitetet joshumicë. Ishte i mendimit që në radhe të parë, kandidati ti plotësojë kushtet për aftësi të merituar, nivelin e duhur shkollor dhe ti përmbush kushtet e përgjithshme. Propozimi i tij ishte që komisioni të miratojë propozim amendamentet dhe të njëjtat ti procedojë për shqyrtim në komisionin Funksional.

Kujtim Shala, përsëri foli për mënyrën e procedimit, gjithmonë duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit, me konstatim se të drejtë të propozojnë amendamente në Projektligj kanë deputeti, grupet parlamentare, komisioni parlamentar dhe Qeveria, në afat prej dy jave pune nga koha e miratimit në parim. Ishte i mendimit se komisioni funksional i ka inkorporuar të gjitha propozim amendamentet e arsyeshme dhe ka dal me raport final. Konsideron se nuk duhet të ndryshohet raporti final, pasi i njëjti duhet të kthehet përsëri për shqyrtim në komisionin Funksional, kështu që mbetet pa u proceduar në Kuvend.

Albert Kinolli, përgëzon komisioni për thirrjen e kësaj mbledhje, që përveç pikave tjera të shqyrtohen këto tre P/ligje të rëndësisë së veçantë të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Sa i përket çështjes së përfaqësimit të komuniteteve dhe kuotës prej 10%, jemi në dijeni se nga kush bëhet diskriminimi. Por duhet Në pyetje janë gjatë komunitete, siç janë: komuniteti turk, boshnjak, goran, rrome, ashkali dhe egjiptian, andaj përqindja e pjesëmarrjes të secilit komunitet në Ushtrinë e Kosovës, duhet të rregullohet me ligj.

Pas diskutimeve të shumta, Zëvendëskryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuar nga deputeti Veton Berisha.

Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se me 3 vota Për, 6 vota Kundër dhe 2 Abstenim , nuk miratohet propozimi i deputetit Veton Berisha.

Zëvendëskryetari hodhi në votim raportin me amendamente të komisionit Funksional, dhe me shumicë të votave, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

11. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me raport amendamente të Komisioni funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Veton Berisha, në bazë të shqyrtimit të Projektligjit për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ai propozoi të shtohen 1 amendamente, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 5 të Projektligjit, shtohet një paragraf i ri nr. 10 me tekstin si në vijim:

‘ 10. Minimum 10% të numrit të përgjithshëm të forcës të rezervohen për pjesëtarët nga komunitetet joshumicë.

Ai dha shpjegim, ky amendament reflekton amendamentet e propozuara në Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Gjithashtu, kërkoi që ky propozim amendament të marrë përkrahjen nga ana e Komisionit.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Zëvendëskryetari hodhi në votim amendamentin e propozuar nga deputeti Veton Berisha.

Zëvendëskryetari, konstatoi se me 3 vota Për, 6 vota Kundër dhe 2 Abstenim , nuk miratohet propozimi i deputetit Veton Berisha.

Zëvendëskryetari hodhi në votim raportin me amendamente të komisionit FunkSIONAL dhe me shumicë të votave, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

12. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Zëvendëskryetar i komisionit,

Xhelal Sveçla